

2019

MARBLE GROUP SHPK

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“MARBLE GROUP” Sh. p. k.

STATUTI

EMERTIMI – OBJEKTI – SELIA – KOHEZGJATJA

NENI 1

Ne qytetin e Durrës, sot me daten **18.09.2019** (dymije e nentembehjete) nga **Ortaket** :

- **Z. LULZIM KARDHIQI**, i biri i Napolon-it, i datëlindjes 02.11.1974, lindur ne Durrës, banues ne Lagjen nr.10 Rr.Eleni Dashi, Nr.10, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, poseduesi i kartes se identitetit menr.033037760/H41102052I.
- **Z. ILIR CENAJ**, i biri i Qemal-it, i datelindjes 01.07.1963, lindur ne Durrës, banues ne Lagjen nr.18 Rr.Jeta e Re, Durrës, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,

eshte themeluar shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“MARBLE GROUP” Sh.p.k.**

Shoqëria **“MARBLE GROUP” sh.p.k.** është person juridik i se drejtes shqiptare, e organizuar ne formen e nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me dispozitat e ketij Statutit te shoqërisë –dhe ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ne perputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndërsa degët që mund te krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega që është miratuar nga ortaku themelues .



NENI 2

Shoqëria Tregtare eshte vendase dhe quhet me emrin **“MARBLE GROUP” Sh.p.k** emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia Qendrore e Shoqërisë **“MARBLE GROUP” Sh.p.k** eshte ne adresen:

Njesia nr.27 me nr.pasurie 243/211-N27, Zona Kadastrale 8512, vol 24, faqe 167, ne adresen Lagjen nr.1 Rr.Taulantia, Kati i Dyte, me siperfaqe 154.3 m2, Durrës – Albania.



NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregëtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit, në çdo vend të Komunitetit Europian.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakeve mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

Njesitë e tjera strukturore të shoqërisë, si Dege apo Perfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë e tillë lejohet dhe legjislativi i vendeve të huaja, **normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregëtar mes vendeve të ndryshme.**

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga kontribute në para dhe është 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i formuar dhe nënshkruar nga Ortaket Themelues :

- **Ortaku themelues Z. LULZIM KARDHIQI:** Zotëruar i 1(një) kuota me vlerë të përgjithshme 50.000 leke (pesëdhjetemijë) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Ortaku themelues Z. ILIR CENAJ:** Zotëruar i 1(një) kuota me vlerë të përgjithshme 50.000 leke (pesëdhjetemijë) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaket me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të karakterit fiskal, ka të drejtë të kryej pagesa apo të japë kontribute, në kapital, ose financime në favor të shoqërisë, të cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe mënyra e rimbursimit të tyre rregullohen me kontratën përkatëse. Shumat e mësipërme mund të përdoren për të mbuluar humbjet ose transferohen direkt në rritjen e kapitalit në përputhje me vendimin e asamblesë së ortakeve.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i perfaqësuar me Letra me vlerë.

NENI 7



Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e regjistrimit Person Juridik në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Me Vendim të Ortakeve kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky Vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendres Kombëtare të Regjistrimit, kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregëtare

NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregëtar në këto Drejtime:

1. **Import,eksport ,tregëti me shumicë e pakicë mermeri, perpunim, prodhim të materialeve të ndryshme si gurë dekorativ, granite e çdo gjë që përfshin, kjo fushë.**
2. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregëtare mbi pasuritë të luajtshme dhe të paluajtshme që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera.
3. Gjithashtu brenda kufijëve të përcaktuar nga ligji mund të leshojë garanci, letra demshperblimi dhe çdo garanci tjetër reale .
4. **Sipërmarrje projektim dhe zbatim i objekteve civile e industrial.** Prodhim parafabrikatesh, elementesh të gatshëm, skela bazamentete të realizuara si elemente baze ose ndihmes .



5. **Zhvillim Kreditim financim** e sigurim i projekteve dhe veprave ndertimore me karakter civil dhe industrial. Ngritje ndertim lartesim ose shnderrim i cdo lloj ndertese vepre ose makineri te nevojshme qe i ndihmojne dhe sherbejne nevojave te shoqerise .
6. **Marrjen pjese ne Panaire** kombetare dhe nderkombetare, qe kane te bejne me celjen dhe zhvillimin e biznesit, ne fushen e ndertimit dhe te teknologjise bashkekohore te tij, me qellim jo vetem ekspozimin e games se prodhimeve ndertimore te firmes por dhe per te mundesuar arrijten emarrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to, si dhe **pjesmarrje ne Tendra brenda e jashte vendit**
7. **Import, eksport, tregti** te artikujve te ndryshem Brenda dhe jashte vendit.

NENI 9

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

Ushtrimin e Aktivitetit tregetar e fillon pasi te jete rregjistruar dhe pajisur me **Certifikaten NIPT** nga Qendra Kombetare e Rregjistrimit.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine tregetare ne perputhje me Legjislacionin shqiptar ne fuqi, si ate tregetar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit te veprimtarise se saj, si dhe mbi bazen e Aktit te Themelimit si dhe Statutin e saj.

KREU II: KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqeria cel Llogari Bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaket dhe Administratorët e Pergjithshëm i caktuar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria dhe terheqja e pjeseve te saj behet kur Çeku bankar eshte firmosur nga Administratorët e Shoqerise, dhe ne rastin kur Ortaket kane caktuar me shume se nje Administrator, i cili eshte jashte ortakerise.

NENI 12

Pjeset e Kapitalit Themeltar, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ortaku ka te drejte qe te transferoj jashte territorit te Republikes Shqiperise pjeserisht apo teresisht Kontributet e saj perfshire dhe Fondet e Kontributet ne natyre.

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themelor, duhet te jene te vertetuara me Kontrate Noteriale dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendimin me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese te tij, vetem ne rast se eshte legalizuar nga nje Noter.

Shoqeria dhe te tretet, duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 13

Kapitali Themeltar i Shoqerise mund te rritet ose zvogelohet, mbi bazen e Vendimit me shkrim qe merret nga ortaket , i cili nenshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bere depozitimin e tij ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit, e cila dhe e ka rregjistruar Shoqerin Person Juridik.

KREU III: ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE, TE DREJTAT DHE DETYRAT



NENI 14 **ASAMBLEJA**

Asambleja e Përgjithshme është organi me i larte vendimor i shoqërisë.

Vendimet e saj merren ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete Statutin dhe janë te detyrueshme. Ato protokollohen ne regjistër te veçante ne përputhje me ligjin.

Asambleja ka te drejte te ushtroje ne çdo moment verifikime mbi Administratorët dhe te kontrolloje çdo dokument te shoqërisë. Ajo mund te urdhëroje apo te udhëzoje administratorin/et ne kryerjen e detyrës se tij.

Asambleja ka keto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive te zhvillimit, perfshire edhe investimet kapitale;
- Vendos per ndryshimet e statutit;
- Emeron dhe shkarkon Administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Vendos per zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendos per transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkembimin) e pasurive te shoqerise, per cedimin apo per dhenien me qira te shoqerise ose degeve te saj, per dhenien me qera te aseteve te shoqerise;
- Vendos per miratimin e huamarrjeve me interes nga te tretet;
- Vendos per dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguroese, dorezanise etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel te miratuar;

- Miraton shperdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes se dividendeve ose vendos per kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit te kapitalit;

- Miraton strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per cdo vend pune ne shoqeri;

Menyra e Thirrjes se Asamblese

Asambleja thirret nga Administratorët ose nga ortaket e shoqerise, nëpërmjet një njoftimi me shkrim.

Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i dërgohet të gjithë subjekteve te interesuar, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Megjithatë janë te vlefshme edhe mbledhjet e Asamblesë qe nuk janë thirrur si me sipër, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali dhe nese ne mbledhje asiston Administratorët dhe eksperti kontabël i miratuar (nëse ben pjese ne strukturen se shoqerise).

Ne Asamble duhet te marrin pjese te gjithë ata qe figurojnë te regjistruar ne librin e ortakeve.

Ortaku ka te drejtën e votës ne Asamble ne proporcion me kuotën qe zotëron ne kapitalin e shoqërisë.


Ortaku mund te përfaqësohet vete, ose nëpërmjet një personi te pajisur me prokure, i cili nuk duhet te jete administrator, apo ekspert kontabël i autorizuar ose vartës i vete shoqërisë apo ndonjë shoqërie tjetër te kontrolluar prej saj. I takon Administratorëve te verifikoje te drejtën e pjesëmarrjes për ortakun.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e përgjithshme merr vendim për vlerësimin e veprimtarisë së tij, shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij, ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria, dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Asambleja drejtohet nga Administratorët dhe ne mungese te yre, pjesëmarrësit ne mbledhje, me shumice absolute te kapitalit prezent ne salle, zgjedhin një drejtues.

Asambleja emëron një sekretar edhe jashte bashkesise se ortakeve. Sekretari mban P/verbalin e mbledhjes i cili duhet te permbaje:

- a) datën kur eshte marrë vendimi;
- b) identitetin e votuesve dhe kapitalin qe ata perfaqesojne;
- c) identifikimin e ortakeve pro, abstenues ose kundra;



- d) sipas kërkeses se ortakeve deklarimet e tyre mbi vendimin e marre;

Vendimi i Asamblesë duhet të nënshkruhet ortaku i vetem i shoqërisë prezent në mbledhje dhe në mungesë të tij nga personi i autorizuar nga vete ai, si dhe nga sekretari. Kur e parashikon ligji, apo kur administratori e sheh të arsyeshme, P/Verbali i mbledhjes mbahet nga një noter i zgjedhur prej tij.

Kuorumi dhe Vendimarrja

Vendimet e Asamblesë që merren me shumicë të zakonshme, janë të gjitha vendimet e Asamblese për të cilat Ligji dhe Statuti nuk kërkojnë një shumicë të cilesuar.

Vendimet që merren me shumicë të zakonshme janë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortaket (me të drejtë vote) që zoterojnë me shumë se 30 për qind të kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nëse është vendosur me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Për Vendimet e Asamblesë që merren me shumicë të cilesuar, mbledhja është e vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortaket (me të drejtë vote) që zoterojnë me shumë se gjysmën e numrit total të kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nëse është vendosur me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakeve pjesëmarrës. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumicë të cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shendrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
- Shpërndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
- Percaktimi i politikës dhe masës së pagave dhe shpërblimeve për çdo pozicion pune në shoqëri, duke përfshirë edhe percaktimin e pages apo shpërblimit të Administratorit, ekspertit kontabel të miratuar dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakeve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

NENI 15

* **Ortakët** kryesisht dhe me anë të Administratorëve, ushtrojnë dhe keto Tagra (të Drejta) :

Mundesohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj siç mund të jënë:

1. Të lidhin Kontrata të ndryshme që kanë për objekt Blerjen, shitjen, kembimin dhe marrjen me qera të Pasurive të ndryshme (të luajtshme dhe të paluajtshme), atë të servitutit, uzufuktit Enfiteozes, Franchising, Siper marrje Ndertimi, etj si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo të Huaj, me shtetin dhe në rastin e blerjes të Pasurive të Paluajtshme apo marrjen e tyre me qera për një kohë mbi 9 vjet, si dhe të Kontratave të Servitutit, Uzufuktit dhe Enfiteozes, duhet të bëjnë regjistrimin pranë Drejtorive Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrave të rrethit të juridiksionit përkatës si për transkriptimin e Pronësive në favor të Shoqërisë apo kalimin e kesaj pasurie në posedim ligjor.

Cdo blerje e pasurive të mesiperme, konsiderohet dhe si shtese e Kapitalit në Natyrë.

2. Të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha Zyrave shtetërore dhe Private, Bankat e çdo niveli etj, që kanë të bëjnë me Garancite, Siper marrjet, marrjen e Kredive, të Sigurimeve dhe Risigurimeve për jetën dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashtë shtetit) kryerjen e veprimeve doganore për zhdoganimin e mallrave të importuara deklarimin e atyre të eksportuar, plotesimit në kohë dhe me rregullsi të dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

NENI 16

5

ADMINISTRIMI

Shoqeria do te perbehet nga nje Administrator i Pergjithshëm të Shoqerise , i cili per te gjithë kohën e tij do te veproj sipas statutit te kesaj shoqerie dhe caktohen:

Erjon Turabi, i biri i Ali-ut, i datelindjes 09.10.1979, lindur ne Kukes, banues ne Durres, madhor me zotesin te plote per te vepruar, posedues i pasaportes me nr.BG3822455/H91009085V

,i cili qendron në këtë detyrë per nje periudhe kohe **5 vjeçare**, duke filluar ky afat nga data e nenshkrimit te ketij Statuti, me te drejte ripërteritje.

Administratori gëzon kompetenca te pakufizuara për realizimin e objektit te veprimtarisë se shoqërisë, me përjashtim te atyre kompetencave qe Statuti ia njeh Asamblesë se Pergjithshme.

Administratori ka te drejten dhe detyrimin qe:

- Të kryej të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Të zbatojë politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- Të përfaqësojë shoqërinë tregtare perpara te treteve;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisi dhe te nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- Të përgatisi buxhetin vjetor te shoqerise.
- Të përgatisi propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe t'i paraqese këto dokumente përpara Asamblesë për miratim;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe dërgoje të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Të raportojë përpara Asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Të propozojë dhe ti paraqesi Asamblese per miratim strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme, organogramen dhe rregulloren e sigurimit teknik;
- Te mos kryejë veprimtari konkurruese (ndalimi i konkuresces) me veprimtari qe kryen shoqeria.
- Administratori ka te drejtë te rimburohet per shpenzimet e bera per arsye pune si dhe te drejten e nje rroge mujore te aprovuar nga Asambleja.

Administratori kryejë edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Ata mund të venë në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokura ne raste gjyqesh, duke kryer operacione bankare, këtu përfshire edhe hapjen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Ortakët dhe Administratori e Shoqerise, të emeruar prej tyre, ka te drejte qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te Shoqerise, te marri ne pune specialiste dhe shtetas te ndryshem madhor dhe me

zotesi te plote per te vepruar, duke lidhur Kontraten sipas kriterëve qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi, te miratuar me Ligjin Nr.7961 dt.12.07.1995 dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin "Per Sigurimet Shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disiplines profesionale te caktuara nga ana e punedhënesit.

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose te tretëve për shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj te tretëve, për aktivitete te kryera nga Administratori ne kundërshtim me kompetencat e tyre, kur vërtetohet se ata (te tretet) ishin ne dijeni te kësaj rrethane.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhene nje motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV:

Pasqyrat Financiare dhe Shperndarja e Shoqerise.

NENI 17

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbyllën me daten **31 Dhjetor** te çdo viti.

Hartimi i Paqyrave Financiare vjetore, behet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe publikohen brenda 6 muajve nga data e mbylljes se vitit financiar.

Per nxjerrjen e rezultatit Kontabel te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit, me vendim te Ortakeve caktohet nje Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka per detyre te kontrolloje dhe verifikojte te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise Ekonomiko tregtare te Shoqerise, si ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille mbi bazen e **Vendimit** te marre nga Ortaket e Shoqerise.


Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatatit perfundimtar te Bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese dhe dorezoje ne kohe Mbledhjes se Asamblese , i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 18

Nxjerrja e rezultateve te Pasqyrave Financiare vjetore, duhet bere me saktësi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe Ligjeve Fiskale ne fuqi, te cilat jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabel i autorizuar perveç te drejtave, ka dhe keto **detyrime**:

1. Garantoni Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktësi dhe konform rregullave te Ligjit " Mbi Kontabilitetin".
2. Te pasqyroje me vertetësi rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare te Shoqerise në mbylljen e vitit financiar te aktivitetit tregtar te saj.
3. Te verifikojte perputhjet me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Administratorët e Shoqerise dhe Ortakut, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblese .



4. T'i beje te njohur Ortakeve dhe Administratorëve te Shoqerise: Kontrolltet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontrole periodike ose vjetore,duke vene ne dukje parregullsitate apo pasaktesite e konstatuar,masat ligjore per rregullimin e tyre etj.

5. Eksperti Kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregetar te Shoqerise, por nuk eshte pergjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Administratorëve te Shoqerise.

NENI 19

Pasqyrat Financiare vjetore, miratohen mbi bazen e Vendimit me shkrim te marre nga Ortaket ne Mbledhjen e Asamblese, ne te cilen jo vetem qe dokumentohet aprovimi e tyre por vendos dhe ne lidhje me disponibilitetin e Fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per Garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Per Formimin e fondit rezerve, qe emertohet "**Rezerve e domosdoshme**" Ortaku vendos qe nga fitimi i akumuluar gjate vitit financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te meparshem, te lere te pakten **1/20 e vleres** se fitimit te realizuar.

NENI 20

Fitimi qe do te shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit financiar te sapo mbyllur. Asambleja mund te vendose për formimin e fondeve te ndryshme dhe shpërndarjen e tyre.

Asambleja pasi ka miratuar Pasqyrat Financiare përfundimtar dhe ka vendosur shumën qe do te shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për secilin ortak ne raport me kuotën qe zotëron secili.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse Administratori, nen përgjegjësinë e tij personale, lëshon një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

NENI 21

Shpërndarja ose Prishja e Shoqerise, mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar Shoqeria siç mund te jene:



- a. Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga Ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".
- c. Me kerkesen e Ortakut Themelues.

Ne kete rast Ortaku merr Vendim me shkrim ne te cilin parashikon dhe menyren e Likudimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likuidatorit.

07.

NENI 22

Akti i Emerimit te Likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon Ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.



NENI 23

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e plote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te veçante apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj.

NENI 24

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise mes te treteve, si rregull dhe pergjithesisht duhet te zgjidhet ne mirekuptim ne te kunderten çeshtjen mund ta bejne objekt konflikti gjyqesor, duke ngritur padi ne **Gjykatën e rrethit Durrës** ose ne **Gjykata Administrative**.

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet udhezimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi, te dhena nga Ortaku vetem themelues i Shoqerise si dhe hapsirave juridike lejuese te Legjislacionit ne fuqi dhe normave nderkombetare.

NENI 26

Ky STATUT u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe dhe me permbajtje e vlere te njejta juridike dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te Shoqerise tregetare **“MARBLE GROUP” Sh.p.k**, Njesia nr.27 me nr.pasurie 243/211-N27, Zona Kadastrale 8512, vol 24, faqe 167, ne adresen Lagjen nr.1 Rr.Taulantia, Kati i Dyte, me siperfaqe 154.3 m2 – Albania. nenshkruset ne te gjitha ekzemplet duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“MARBLE GROUP” Sh. p. k.

Miratuesit e ketij Statuti

(ORTAKET E SHOQERISE)

LULZIM KARDHIQI



ILIR CENAJ

